



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VIII**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Mbledhja nr. 03 .**

**Prishtinë, më 1.6.2021, në orën 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Verica Ceraniq, kryetare e Komisionit; Hydajet Hyseni dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetar. Anëtarë të tjerë: Drita Millaku, Arjeta Fejza, Elmi Reçica, Ivan Todosijeviq, Miljana Nikoliq, Zoran Mojsiloviq, Jasmina Dediq, Milosh Peroviq, Enis Kervan, Adem Hodzha, Fadil Gashi, Fridon Lala dhe Bekim Arifi.

Munguan: Behxhet Pacolli dhe Shemsedin Dreshaj

Emrat e pjesëmarrësve tjerë: Liridona Gashi, këshilltare politike e KRK; Reshat Nurboja, këshilltar politik i kabinetit të KK; Festim Bytyçi, GP/AAK; Zijush Ahmeti, zyrtar nga SKKK dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Verica Ceraniq**, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit për Projektligjin nr.08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurën Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091 të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

**3. Shqyrtimi i** Raportit për Projektligjin nr.08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurën Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091 të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

**Kryetarja**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurën Penale dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin e komisionit funksional.

**Elmi Reçica**, theksoi se komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin nr.08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurën Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091 dhe i njëjti ka dalë me raport final, të cilin e ka përcjell për shqyrtim në komisionet e përhershme.

Në fakt, unë dhe GP i PDK-së e mbështesim këtë Projektligj, në parim.

Mirëpo, ai diskutoi lidhur me disa çështje të Projektligjit, të cilat kanë një rëndësi së veçantë. Projektligji nr.08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurën Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, parasheh ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, respektivisht nenin 346 A.

Sipas këtyre ndryshimeve të propozuara, parashihet të fshihet neni 157, që ka të bëjë me pezullimin e hetimit, ndërsa shtohet neni 159, që ka të bëjë me afatet kohore.

Gjithashtu, parashihet të fshihet paragrafi 4.1 të nenit 364 A të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.06/L-091, sipas të cilit parashihej që personi nën hetim të jetë kërkuar në shtetin ku supozohet se mund të jetë së paku 5 herë.

Direktiva 2016/346 e Parlamentit Evropian e datës 9 mars 2016 mbi forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë; i pranishëm në gjykim në procedurë penale, neni 9 i saj, parasheh edhe të drejtën për gjykim të ri të personave të dyshuar apo të akuzuar, të cilët nuk kanë qenë; prezent gjatë gjykimit të tyre dhe nuk janë plotësuar kriteret e parapara në nenin 8, paragrafi 2 të Direktivës ( këto kritere thonë se gjykimi në mungesë mund të bëhet nëse i dyshuari apo i akuzuari ka qenë; i informuar në kohë të duhur e përshtatshme për gjykim, si dhe për konsekuencat e mungesës së tij, dhe se i dyshuari apo personi i akuzuar të ketë të drejtën të jetë i përfaqësuar nga avokati i zgjedhur nga ai, apo të përcaktuar sipas detyrës zyrtare).

Formulimi i nenit 8, paragrafi 2 të Direktivës së 2019/343 të BE-së, se njëri nga kushtet e gjykimit në mungesë është fakt se personi i dyshuar apo i akuzuar duhet të ketë qenë i informuar në kohë të duhur apo të përshtatshme për gjykim, krijon hapësirë për interpretim dhe paqartësi.

Kush e definon gjatësinë e kësaj kohe të duhur apo të përshtatshme që nevojitet si fakt se i dyshuari apo akuzuari ka qenë i informuar?

Ndryshimet për hetimin, gjykimin dhe dënimin në mungesë të personave të dyshuar për krime lufte gjatë luftës së fundit në Kosovë, ishin iniciuar nga partia që sot është në pushtet dhe këta tani pretendojnë që një gjë e tillë ka qenë bërë gabim dhe tani synojnë ta përmirësojnë gabimin e tyre.

( Gabimi i tyre që e kanë bërë me rastin e ndryshimeve të kodit të procedurës penale, të bërë më 1919, është ky: ata në vend se ta fshijnë nenin 159 të Kodit të Procedurës Penale që ka të bëjë me afatet e hetimit, e kanë fshi nenin 157 që ka të bëjë me pezullimin e hetimit).

Në parim, ne përkrahim një iniciativë të tillë, por duhet pasur kujdes me mënyrën se si bëhet, sepse nuk është aspak serioze që, për çështje të tilla kaq të rëndësishme, të bëhen gjërat gabim. Kush mund të besojë se pas një kohe partia në pushtet prapë të dalë me një propozim për një ndryshim të ri, i cili do të ndryshonte ndryshimin që po kërkojnë ta bëjnë tani?!

Gjykimi në mungesë për veprat penale kundër të drejtës humanitare dhe të drejtës ndërkombëtare penale, gjatë periudhës janar 1999 deri në qershor 1999 në Kosovë, edhe mund të bëhet, por drejtësia nuk vihet në vend e familjarët e viktimave nuk ndjehen mirë nëse të njëjtit nuk vihen para grilave.

Për një gjë të tillë nevojitet bashkëpunimi policor, por që e njëjta qeveri ka vendosur që edhe këtë vit të mos aplikojë për anëtarësim në Interpol!

Pra, paradoksi është se në njërin anë qeveria kërkon të shtyjë gjykimin në mungesë e në anën tjetër gjykimi në mungesë nuk mund të bëhet efektiv nëse të njëjtit nuk vuajnë dënimin e shqiptuar, kurse për të vuajtur dënimin nevojitet prania jonë në Interpol, por që kjo qeveri nuk ka ndërmend të aplikojë për anëtarësim në familjen e madhe të bashkëpunimit policorë ndërkombëtarë. Ndërkohë, Kosova nuk mund të bëjë ekstradim nga Serbia sepse nuk kemi marrëveshje. Fundja, ky është stili i punës së qeverisë së mashtrimit, e cila në këtë rast është duke mashtruar e manipuluar me këtë çështje, sepse nuk e ka përnjëmend, përndryshe nuk do të kishin bërë gabime të tilla.

E përsëriti se e mbështetë projektligjin në parim, por duhet theksuar se gjërat janë bërë gabim dhe ato tani po provohen të përmirësohen.

**Enis Kervan**, para vetës e kemi Raportin e Projektligjit nr.08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurën Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, të miratuar nga komisioni funksional, me ç ‘rast deklarohet se edhe unë pajtohem për miratimin e të njëjtit.

Ai diskutoi në lidhje me një temë tjetër kur bëhet fjalë për raportet e komisioneve funksionale ishte i mendimi se ato nuk duhet të trajtohen vetëm nga ana formale. Do të ishte më korrekte që paraprakisht, projektligjet t’u dërgohen anëtarëve të këtij komisioni, me arsye që të ofrojmë mendimet tona konkrete, të cilat më pas do të procedohet në komisionet përkatëse.

**Kryetarja**, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, raportet e komisioneve funksionale dorëzohen 5 ditë pune, në komisionet e përhershme, andaj nga aspekti formal juridik nuk kemi mundësi t’i tejkalojmë kompetencat dhe të dalim me propozime të reja.

Sa i përket propozimit të deputetit Reçica, vërejtjet e tij mundet t’i paraqesë në Kuvend.

Kur bëhet fjalë për tekstet e projektligjeve, Zyra për propozime dhe parashtrësia iu procedon të njëjtat secilit deputet, andaj nuk e shoh si alternativë që të njëjtat të dyfishohen.

**Hydajet Hyseni**, theksoi se e respekton propozimin e deputetit Reçica, materiali i cili do të pasuronte dhe lehtësonte jo vetëm miratimin e ligjit, por edhe zbatimin e tij në praktikë.

Sa i përket çështjes së shtruar, unë jam i rezervuar që të jetë objekt i shqyrtimit në komision.

Duke pasur parasysh fushëveprimtarinë e komisionit, në kompetencën tonë është shqyrtimi i projektligjeve nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Që të jemi sa më funksional, ekziston procedura që ky propozim të shtrohet në Kuvend.

Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin në të gjitha fazat, dhe më pas ka hartuar raportin përfundimtar, ku të njëjtin e ka proceduar për shqyrtim tek komisionet e përhershme.

Qëndrimi i tij ishte që, raporti përfundimtar i komisionit funksional të hodhët në votim dhe më pas të procedohet për miratim në Kuvend.

**Kryetarja**, e hodhi në votim Projektligjin nr.08/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 04/L-123 të Procedurën Penale, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091 dhe raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetarja konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, me 8 vota Për, 8 vota Kundër dhe asnjë abstenim, Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

#### *Përfundim*

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit të Komisionit funksional dhe në bazë të rezultatit të votimit, Komisioni nuk miratoi të njëjtat për procedim të mëtejshëm.*

**Hydajet Hyseni**, duke u ndërlidhur sërish sa i përket procedurave të votimit, mirë është që votimi kundër të arsyetohet, për faktin se duhet të dihen arsyet e vërejtjes.

**Drita Millaku**, meqë nuk ishte e pranishme në fillim të mbledhjes, kërkoi të informohet se cilat subjekte politike kanë votuar kundër raportit përfundimtar të projektligjit.

Këtë e theksoi duke u bazuar se secili subjekt politik i ka përfaqësuesit në komisionin për legjislacion dhe secili ka pasur të drejtë t'i adresojë vërejtjet apo sugjerimet e tyre.

**Kryetarja**, shtoi se në rend të ditës është shqyrtimi i Raportit përfundimtar të komisionit funksional, i cili është proceduar me kohë dhe se secili komision i përhershëm ka votuar sipas qëndrimeve të tyre. Andaj, edhe në komisionin votuar sipas bindjeve tona.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:40.*

*Përgatitur nga;*

*Njësia mbështetëse e komisionit*

*Verica Ceraniq*

**Kryetare e komisionit,**

---